

Tako Zotin

«Shtatëdhjetë herë shtatë» (Mateu 16:21–35)

Në vitin 1818, Tamatoe, mbret i Huahinës, një nga ishujt e Detit Jugor u bë kristian. Pas një farë kohe ai zbuloi se banorët vendas po përgatisnin një komplot të lig, për të kapur atë dhe kristianë të tjerë dhe për t'i djegur.

Tamatoe, me një grup ushtarësh, i kapi komplotuesit, pa përdorur dhunë. Pastaj, organizoi një festë të madhe për ta. Ishte një shenjë faljeje që erdhi nga shembulli i faljes së Jezusit.

Kjo mirësi e papritur e Tamatoes i çuditit banorët e egër, të cilët i dogjën idhujt e tyre dhe u bënë kristianë. Fuqia e faljes është e mrekullueshme.

Falja është e fuqishme. Të kesh një zemër që fal përbën një pjesë të rëndësishme të planit të Zotit për njerëzit e Tij. Kjo është treguar në shembelltyrën e shërbëtorit të pamëshirshëm, që gjendet vetëm te Mateu 18.

MËSIMI PËR FALJEN (MATEU 18:21, 22)

Në një rast Pjetri erdhi te Jezusi dhe e pyeti: «Zot, në se vëllai im mëkaton kundër meje, sa herë duhet ta fal? Deri në shtatë herë» (v. 21). Nuk jemi të sigurt pse Pjetri përdori shifrën «shtatë». Mësuesit e ligjit thoshin se njerëzit duhet të falin deri në tre herë.¹ Ndoshta Pjetri u përpoq të përmirësonte numrin e tyre. Ndoshta Pjetri përdori numrin shtatë sepse ky numër përdorej shpesh për të treguar plotësinë. Ndoshta Pjetrit iu kujtua se Jezusi e kishte përdorur numrin shtatë kur foli për faljen: «Edhe sikur të mëkatonte shtatë herë në ditë kundër teje, dhe shtatë

herë në ditë do të kthehet te ti duke thënë: “Pendohem”, fale» (Luka 17:4).

Jezusi iu përgjigj Pjetrit: «Unë nuk të them deri shtatë herë, por deri shtatëdhjetë herë shtatë» (v. 22), me fjalë të tjera, deri në 490 herë!² Jezusi përdori këtë numër të madh për të dhënë dy mësime të rëndësishme pér faljen: Së pari, ne duhet të mësohem të falim. Kur falim dikë 490 herë tregon se e kemi bërë zakon faljen. Së dyti, ideja e të mbajturit mend se kush na ka lënduar, dhe sa shpesh i kemi falur është absurde. Sa qesharake do të ishte të mbanin shënim çdo herë që falnim dikë, duke thënë: «Kjo është hera e pesëmbëdhjetë që e fal. Do ta fal edhe 475 herë të tjera, jo më tepër!» Dashuria «nuk kërkon të keqen» (1 Korintasve 13:5).

Ajo që Jezusi i tha Pjetrit ishte diçka praktike. Falja është pjesë e rëndësishme e planit të Jezusit pér kishën e Tij. Ai i udhëzoi ndjekësit e Tij:

Sepse në qoftë se ju ua falni njerëzve gabimet e tyre. Ati juaj qiellor do t'ua falë dhe juve; por në qoftë se ju nuk ua falni njerëzve gabimet e tyre, as Ati juaj qiellor nuk do t'ua falë juve gabimet tuaja (Mateu 6:14, 15).

Mos gjyconi dhe nuk do të gjykoheni; mos dënoni dhe nuk do të dënoheni; falni dhe do të jeni të falur (Luka 6:37).

ILUSTRIMI I FALJES (MATEU 18:23–35)

Pasi i tha Pjetrit të falë «shtatëdhjetë herë

shtatë», Jezusi e përforcoi mësimin e Tij duke treguar një shembelltyrë: shembelltyrën e shërbëtorit të pamëshirshëm.

Prandaj mbretëria e qiejve i ngjan një mbreti që deshi të bënte llogaritë me shërbëtorët e vet. Mbasi filloj t'i bëjë llogaritë, i sollën një që i detyrohej dhjetë mijë talenta (Mateu 18:23, 24).

Imagjinoni në mendjen tuaj këtë skenë: Mbreti ndoshta ishte kthyer nga një udhëtim i gjatë dhe mblodhi shërbëtorët dhe skllavërit e tij. Një nga një, ata qëndruan përparrë fronit të tij dhe dhanë llogari për shërbimin e tyre. Më në fund, përparrë tij qëndroi një skllav, që kishte besimin e tij të plotë, sepse pronari i tij i kishte besuar atij shuma të mëdha parash. Në fillim shërbëtori po qeshte, por pamja e tij plot besim u shndërrua në një pamje të dëshpëruar, kur librat e llogarisë treguan se ai kishte përvetësuar dhjetë mijë talenta nga të mbretit!

Nuk mund të jemi të sigurtë rrith vlerës së saktë të «dhjetë mijë talentave». Një «talent» nuk ishte monedhë, por ishte një peshë e caktuar metali të çmuar. Meqënëse pesha ndryshonte nga zona në zonë (ashtu siç ndryshonte vlera e metalit), atëherë vlera e dhjetë mijë talentave ndryshonte shumë. Do të jetë e mjaftueshme të themi se shuma ishte astronomike. Për qëllimin tonë, ne do të përdorim shifrën 10 miliardë lekë, që është ndoshta shumë e vogël krahasuar me vlerën e vërtetë sot në treg.³ Mos u ngatërrro me detajet (për shembull, si arriti një skllav të krijojë një borxh kaq të madh?) Ideja e Jezusit ishte se njeriu kishte një borxh kaq të madh sa e kishte të *pamundur* që ta paguante.

Vargu 25 tregon se skllavi s'kishte ndonjë «mundësi që të paguante» të dhjetë mijë talentat. Ndoshta ai i kishte humbur paratë në baste, apo kishte bërë ndonjë investim pa mend. Sidoqoftë, paratë kishin avulluar dhe s'kishte ndonjë rrugëzgjidhje për të paguar mbretin. Kur mbreti e kuptoi situatën, ai «urdhëroi që të shitej me gruan e tij, bijtë e tij dhe gjithë ç'kishte, dhe të shlyej detyrimin» (v. 25b). Kjo ishte një praktikë e zakonshme. Meqënëse shpagimi s'mund të bëhej, kjo do të kuptonte një dënim për jetë, për shërbëtorin dhe gjithë familjen e tij.

Kur mbreti dha dënimin, skllavi u përkul përparrë mbretit dhe filloj t'i lutej: «Zot, ki durim me

mua dhe unë do t'i paguaj të gjitha» (v. 26). Ky ishte një premtim qesharak, sepse skllavi kurrë nuk do të mund të paguante të zotin e tij, por e tha këtë nga dëshpërimi!

Pastaj Jezusi dha këtë shembull të bukur të faljes: «i shtyrë nga dhembshuria, zotëria i atij shërbëtori e la të lirë atë dhe ia fali detyrimin» (v. 27).

Sidoqoftë, Jezusi nuk kishte mbaruar me shembelltyrën e Tij. «Por ai shërbëtor, si doli, takoi një nga shërbëtorët e tjerë, që i detyrohej njëqind denarë» (v. 28a). Skllavit që porsa i ishte falur borxhi prej 10 miliardë lekë ndoshta mendoi se duhej ta festonte! Meqënëse s'kishte para, vendosi të kërkonte një shok që i kishte borxh 100 dinarë.

*Falja ka më
shumë vlerë
për atë që fal,
se sa për atë
që falet.*

Një denar ishte paga ditore e një punëtori në atë kohë. Përsëri, s'mund të jemi shumë të sigurtë për të konvertuar këtë vlerë në lekun e sotëm. Punëtorët në atë kohë punonin me rroga qesharake; nuk kishte ndonjë ligj për «pagë miniale» që t'i mbronte ata. Për qëllimet tona, do të përdorim shifrën dy mijë lekë. Shuma e saktë nuk është e rendësishme. E rendësishme është që shuma ishte shumë e vogël krahasuar me atë që mbreti i fali skllavit.

Skllavi të cilit i ishin falur 10 miliardë lekë më në fund gjeti shokun e tij. Kur e pa atë, «e zuri për fytin, po e mbyste duke i thënë, “Më paguaj detyrimin që më ke”» (v. 28b). E imagjinoj të bërtiturën e tij, «më jep dy mijë lekët e mi!», ndërsa e kap prej gryke.

Menjëherë, «shërbëtori shok i tij, i ra ndër këmbë [ashtu si skllavi i parë kishte bërë me mbretin] dhe iu lut duke thënë: “Ki durim me mua dhe do t'i paguaj të gjitha”» (v. 29). Këto ishin të njëjtat fjalë që skllavi i parë kishte përdorur kur iu lut mbretit përfalje. Fjalët duhet

t'i kishin kujtuar rastin e tij, por jo. Këtij njeriu i ishte falur borxhi prej 10 miliard lekësh, por ai nuk donte të falte borxhin prej dy mijë lekësh! Skllavi ishte i inatosur sepse ai s'mund t'i merrte dy mijë lekët. Ai nuk do të kishte para për të festuar!

I egërsuar, ai «shkoi dhe e futi në burg deri sa ai ta shlyente detyrimin» (v. 30).⁴ Meqënëse njeriu nuk mund të bënte para brenda në burg, shërbëtori i pamëshirshëm e dënoi atë për jetë në burg, vetëm për disa dollarë!

Veprimet e tij u vunë re nga skllevërit e tjerë. «Por shërbëtorët e tjerë, kur e panë ngjarjen, u pikëlluan shumë dhe shkuan e i thanë zotërisë së tyre gjithçka që kishte ndodhur» (v. 31). Mbreti u inatos.

Atëhere zotëria e tij e thirri dhe i tha: «Shërbëtor i lig, unë ta fala gjithë këtë detyrim, sepse m'u lute. A nuk duhej të kiske mëshirë edhe ti për shokun tënd, ashtu si pata mëshirë unë për ty? Dhe zotëria e tij, i zemëruar, ua dorëzoi torturuesve deri sa të paguante gjithë detyrimin (vargjet 32–34).

S'ka dyshim se skllavi përsëri iu lut mbretit, por kësaj here më kot. Ai kërkoi drejtësi dhe mbreti i dha drejtësi! Borxlinjtë disa herë do-rëzoheshin tek torturuesit të cilët përdornin tortura të tmerrshme për t'i detyruar ata të tregonin ndonjë burim parash që ata e mbanin të fshehur. Meqë skllavi nuk kishte ndonjë burim të fshehtë parash, do të thotë se ai do të torturohej *përgjithmonë* (ndoshta kjo është një referencë për dënimin e përjetshëm.)

Jezusi e përfundoi shembëlltyrën me këto fjalë: «Kështu do të veprojë me ju edhe Ati im qiellor, në qoftë se secili prej jush nuk e fal me gjithë zemër vëllanë e vet për fajet e tij» (v. 35). Mund të zgjedhim të falim apo të harrojmë faljen që Zoti dëshiron të na japë! Te Jakobi 2:13 gjysmë-vëllai i Jezusit shkroi këto fjalë: «Gjykim do të jetë i pamëshirshëm për ata që nuk treguan mëshirë!»

Shumë mësimë të rëndësishme mund të nxirren nga kjo shembëlltyrë. Një është gjendja e pashpresë e një mëkatari pa hirin e Zotit. Njeriu që kishte 10 miliardë lekë pëershruan secilin prej nesh. Shpirtërisht ne kemi një borxh të cilin kurrë s'mund ta paguajmë. Ne të gjithë jemi mëkatarë (Romakëve 3:23) dhe paga e mëkatit

është vdekja shpirtërore (Romakëve 6:23). Fat-keqësisht, disa nga ne mund t'i ngjajnë njeriut që iu lut mbretit: «Ki durim me mua dhe unë do t'i paguaj të gjitha» (v. 26). Disa besojnë se shpirtërisht mund të ripaguajnë Zotin për mëkatet e tyre me jetët e tyre të mira dhe me veprat e mira që bëjnë. «Zot, më jep edhe pak kohë dhe unë do t'i rregulloj të gjitha». Kjo shembëlltyrë tregon se është e pamundur për njeriun të ripaguajë Zotin, edhe nëse përpinqet me mijra vite. Ne duhet ta kuptojmë këtë, nëse duam të vlerësojmë atë që Zoti ka bërë për ne!

Sidoqoftë, mësimi qendoror i kësaj shembëlltyrë është se ai që falet duhet të falë. Një nga mësimet e shpjeguara shumë qartë në Dhjatën e Re është se, meqënëse Perëndia na ka falur, ne duhet të jemi gjithmonë të gatshëm të falim të tjerët. Pali u shkroi këto fjalë vëllezërve në Efes dhe Kolose:

Le të flaket larg jush çdo hidhërim, zëmërim, inat, trazirë dhe shpifje me çdo ligësi. Por jeni të mirë dhe të mëshirshëm njeri me tjetrin, duke e falur njeri-tjetrin, sikurse edhe Perëndia ju ka falur në Krishtin (Efesianëve 4:31, 32).

Duke duruar njëri-tjetrin dhe duke falur njëri-tjetrin, në qoftë se dikush ankohet kundër një tjetri; dhe sikundër Krishti ju ka falur, ashtu bëni edhe ju (Kolosianëve 3:13).

DISKUTIMI PËR FALJEN

Çfarë do të thotë të falësh

Cili është kuptimi i faljes? Dikush mund të na këshillojë «fal dhe harro». Sidoqoftë, ata që kanë studjuar mendjen njerëzore, tregojnë se është e pamundur që ne «të falim dhe harrojmë» me të vërtetë. Çdo gjë që e kemi parë, dëgjuar apo provuar ndonjëherë, ka mbetur diku në trurin tonë. Kjo nuk është diçka e keqe. Madje dhe Zoti nuk «fal dhe harron» tërësisht. Përndryshe, ne nuk do të kishim librin e Zanafillës, që përmban mëkate që janë falur para shkrimit të librit. Moisiu nuk do të kishte njohur detajet e mëkateve të kryera mijra vite më parë, nëse Zoti nuk do t'i kishte dhënë atij këto detaje me anë të frymëzimit. Kështu, Zoti i «mbajti mend» këto mëkate, edhe pse disa prej tyre ishin falur shumë vite më parë. Kur Bibla tregon se Zoti i fal mëkatet dhe nuk i kujton më (Jeremia 31:34; Hebrejnjtë 8:12), çfarë do të thotë kjo? Do të thotë që, prej asaj

kohe, Zoti do tē na trajtojë *sikur* mëkatet tē mos kishin ndodhur. Dikush ka thënë:

«Falja» sipas Biblës do tē thotë «që tē mos influencohesh më apo tē prekesh nga mëkat». Kur Zoti prenton: «Dhe unë nuk do t'i kujtoj më mëkatet e tyre dhe paudhësitë e tyre» (Hebrejnje 10:17), Ai nuk po thotë se menjëherë do tē pajiset me një kujtesë tē dobët! Kjo është e pamundur për Zotin. Zoti thotë: «Unë nuk do t'i marr më në konsideratë mëkatet e tyre. Mëkatet e tyre nuk mund tē influençojnë më marrëdhëniet e tyre me Mua apo tē ndryshojnë sjelljen Time ndaj tyre.»

Detyra jonë është tē mësojmë që tē bëjmë tē njëjtën gjë.

Për vite tē tëra, ndërsa jam përpjekur tē ndihmoj njerëzit që kanë probleme në marrëdhëniet midis tyre, shumë nga ata kanë zbuluar se është e dobishme që falja tē zhvillohet në dy hapa, në zemrat njerëzore:

Në një farë mënyre falja mund tē jetë e *mnejëhershme*. Teksti ynë ka theksuar këtë aspekt tē faljes. Romakëve 12:18–21 tregon për disa nga sjelljet dhe veprimet që përfshihen në faljen afatshkurtër:

«Po tē jetë e mundur dhe aq sa varet prej jush, jetoni në paqe me tē gjithë njerëzit. Mos u hakmerrni për veten tuaj, o tē dashur, po i jepni vend zemërimit tē Perëndisë, sepse është shkruar: «Mua më përket hakmarrja, unë kam për tē shpaguar, thotë Zoti». «Në qoftë se armiku yt ka uri, jepi tē hajë; në pastë etje jepi tē pijë; sepse, duke bërë këtë, do tē grumbullosh mbi krye tē tij thëngjij tē ndezur». Mos u mund nga e keqja, por munde tē keqen me tē mirë.»

Më poshtë janë disa përfundime që dalin nga këto vargje te kapitulli 12 i Romakëve:

(1) Kur falim tē tjerët, duhet tē përpiqemi tē veprojmë ashtu si veproi Zoti duke i trajtuar ata sikur asgjë tē mos kishte ndodhur. Ne do tē gjejmë disa përjashtime praktike madje edhe biblike⁵ në këtë parim, por me aq sa mundemi ne përpinqemi tē mos lemë tē kaluarën tē influençojë marrëdhëniet tona. Nuk përpinqemi që tē izolohemi nga këta individë. Nuk refuzojmë t'u flasim. Në marrëdhëniet tona vendosim që tē mos përmendim tē kaluarën. «Po tē jetë e mundur dhe aq sa varet prej jush, jetoni në paqe me tē gjithë njerëzit».

(2) Kur falim ata që na ofendojnë, duhet tē vendosim tē mos hakmerremi. Kjo përfshin më-

nyrën se si flasim për ta me tē tjerët. Nuk përpinqemi që «t'u përgjigjemi» në tē njëjtën mënyrë atyre që na lëndoijnë. I lëmë këto gjëra në dorën e Zotit. «Kurrë mos u përpinq që tē hakmarrresh, ... sepse është shkruar: “Mua më përket hakmarrja, Unë do tē shpaguaj” thotë Zoti».

(3) Kur falim tē tjerët, duhet tē «dëshirojmë që më e mira tē ndodhë» për ata që falim; dëshirojmë mirëqenien e tyre. Kjo është një pjesë e rëndësishme e dashurisë *agape*, e cila duhet tē përfshijë gjithë njerëzit. «Por, nëse armiku juaj ka uri, jepi tē hajë, dhe, në pastë etje, jepi tē pijë.»

(4) Kur falim tē tjerët, duhet tē përpinqemi që tē çrrënjosim nga zemrat tona gjithë urejtjen dhe armiqësinë për ta. «Mos u mund nga e keqja, por munde tē keqen me tē mirë.»

Kjo keshillë e fundit na sjell tek shqyrtimi i faljes me *afat tē gjatë*. Edhe pse falim menjëherë, ndoshta do tē vazhdojmë tē luftojmë brenda vetes me ndjenjat e këqija për ata që na lënduan. Akoma mund tē kemi përbrenda ndjenja armiqësore për ta. Falja afatgjatë mund tē jetë një proces i gjatë dhe i vështirë. Mund tē duhen vite, ndoshta një jetë e tërë.

Duhen bërë dy hapa për faljen afatgjatë. Në fillim duhet tē vendosim që kurrë tē mos dorëzohemi. Duhet tē vazhdojmë tē mendojmë sikur asgjë tē mos kishte ndodhur midis nesh dhe atyre që na kanë dëmtuar. Duhet tē disiplinojmë ndjenjat tona tē brendshme, ashtu si thotë proverbi, koha me tē vërtetë mund tē shërojë plaqët tona.

Hapi i dytë është që tē kalojmë shumë kohë në lutje. Ne duhet t'i lutemi Zotit vazhdimisht që tē na ndihmojë. Duhet tē mbajmë mend se «me Zotin gjithë gjërat janë tē mundshme» (Mateu 19:26). Ne duhet tē lutemi vazhdimisht për atë që na lëndoi, ashtu si u lut Jezusi në kryq: «O Atë, fali ata sepse nuk dinë ç'bëjnë» (Luka 23:34). Është e vështirë që tē lutemi vazhdimisht për dikë dhe, në tē njëjtën kohë, t'i mbajmë mëri.

Do ta kuptojmë që falja me afat tē gjatë po zhvillohet në zemrat tona, kur incidenti që ndodhi nuk kontrollon më tē menduarit tonë, por fillon tē venitet nga kujtesa jonë. Do ta kuptojmë se procesi ka përfunduar, kur tē jemi në gjendje tē *kujtojmë incidentin pa u lënduar*. Është e vë-

shtirë që ta arrijmë këtë pikë në jetë. Në se e arrijmë, atëhere kjo do të ishte një fitore! Ne duhet të falenderojmë Zotin që na ndihmoi për të arritur maturi më të madhe në jetën tonë si kristianë.

Çfarë do të bëjë falja për ne

Kur e bëjmë zakon të falim të tjerët, do të zbulojmë se falja influencon më shumë atë që fal se sa atë që falet. Hidhërimi do të mbushë zemrën tonë, nëse nuk falim. Hebrenje 12:15 na paralajmëron për këtë dobësi: «Kujdes që askush të mos mbetet pa hirin e Perëndisë dhe të mos mbijë ndonjë rrënje e hidhur dhe t'ju turbullojë dhe me anë të saj të ndotet shumë njerëz».

Përsëri, falja do të na çlirojë. Nëse lejojmë armiqësinë të zotërojë shpirtrat tanë, të mbushë mendimet tona ditën dhe të na mbajë pa gjumë natën, atëhere në këtë mënyrë ne po lëmë armiqësinë të kontrollojë jetët tona. Grumbullimi i hidhërimit nuk dëmton njerëzit e tjerë, por na dëmton ne. Falja për ata që na kanë dëmtuar bën që ne të heqim ndjenjën e urrejtjes, të çlirohem nga hidhërimi dhe t'u kthehem i jetëve tona si kristianë!

S'është për t'u çuditur që Jezusi na urdhëroi që të falim ashtu si jemi falur! Falja na ndihmon shpirtërisht, emocionalisht dhe fizikisht. Një shkrimtar ka shkruar:

Perëndia na ka urdhëruar që të falim njëri-tjetrin, jo vetëm si një kërkësë e ligjit të Tij apo rregull për të mbajtur paqen, por për të mirën tonë. Mbajtja përbrenda e mërisë dhe urrejtjes janë shumë të dëmshme pér shëndetin fizik dhe mendor. Kjo dëmton aftësinë pér të pasur dhe mbajtur marrëdhënie të rëndësishmepër t'u kujdesur ashtu siç duhet pér fëmijët, apo pér të pasur sukses në punën që kryeni. Gjithashtu shkatteredon shëndetin dhe gëzimin, sepse lumturia dhe shëndeti nuk mund të bashkëjetojnë me urrejtjen dhe mërinë. Falja e vërtetë, në anën tjetër, shoqërohet nga premtimi i përjetshëm i Perëndisë pér gëzim dhe kënaqësi.

KONKLUSION

Le të përpinqemi ta bëjmë këtë mësim sa më praktik që të jetë e mundur. Cilin do Perëndia që ju të falni? A ju ka dëmtuar dikush në të kaluarën? A i mbani akoma mëri tij. A e keni falur me gjithë zemër atë njeri? Nëse e keni falur, a po

bëni të gjitha përpjekjet që incidenti i së kaluarës të mos ndikojë marrëdhënet tuaja? A vazhdoni të përmirësoni sjelljen tuaj? A luteni çdo ditë pér atë që ju lëndoi.

Në qoftë se në zemër gjeni hidhërim në vend të faljes, lутем që të gjeni një mënyrë pér ta falur atë njeri. Mbani mend dy mësimet kryesore: (1) Ne jemi falur pér 10 miliardë lekë mëkate; si rrjedhim, duhet të jemi gati të falim të tjerët pér dy mijë lekë mëkate. (2) Në qoftë se nuk falim, nuk mund të falemi.

Zoti na ndihmoftë që të mësojmë si të falim!

SHËNIME

¹Kjo bazohet në mësimet e tyre tek Amosi 1 dhe 2. Arsyetimi ishte se Zoti i fali kombet e tjerë pér tre të këqija dhe në të katërtën Ai tregoi zémërimin e Tij (Amos 1:3). Zoti nuk do të presë më shumë pér njerëzit.

²Disa shkrime antike kanë «shtatëdhjetë plus shtatë». Zanafilla 4:24 përdor termin e njëjtë. Shifra e saktë nuk është e rëndësishme. Jezusi përdori një shifër të ekzagjeruar, pavarësisht 77 apo 490, pér të na mësuar se s'duhet të ketë ndonjë limit pér faljen tonë.

³Shuma totale e taksave që mblidheshin në Palestinë pér një vit ishte 800 talenta. Punëtori i zakonshëm duhet të punonte 20 vjet që të fitonte një talent. Vetëm Davidi dhe princat e tij furnizuan pak më shumë se dyfishin i asaj shume pér ndërtimin e tempullit (1 Kronikave 29:4–7). Disa mendojnë se 10 mijë talenta do të kenë vlerë më të madhe se një bilion dollarë sot!

⁴Ndoshta në bazë të ligjit ky burrë kishte të drejtë të bënte këtë por ai nuk kishte të drejtën morale të vepronte në këtë mënyrë, sidomos po të mendojmë se ai sapo ishte trajtuar në mënyrë të mëshirshme.

⁵Madje edhe n.q.s. ti fal një njeri që ju vjedh diçka, illogjika thotë që ti s'mund ta vendosësh atë njeri të administrojë paratë e tua. Nëse ti fal një grua që abuzoi me fëmijën tënde, ti nuk do ta punësosh atë grua menjëherë pér t'u kujdesur pér fëmijën tënde. Pér përjashtimin Biblik, një shembull do të mjaftojë: Nëse një bashkëshort ka shkelur kurorën dhe vjen tek ty duke kërkuar falje, ti duhet ta falësh atë. Kjo nuk do të thotë se ju jeni të detyruar të jetoni me atë njeri si burrë apo grua, sikur asgjë të mos kishte ndodhur (Mateu 19:3–9). Incidente të tillë janë përjashtim pér rregullin. Përvoja ime ka qenë se, në shumicën e rasteve, çfarë u lënduan ishin ndjenjat tona, në të tillë raste këto përjashtime nuk aplikohen.

Kërkimi pér të humburit

Lista e Jezusit pér «kandidatët e mundshëm» ishte e çuditshme: Ai zgjodhi Mateun tagrambledhësin si një nga 12 apostujt e Tij, Ai këshilloi gruan që kishte pesë bura tek burimi, dhe hëngri në shtëpinë e Zakeut! Sa të ndryshme janë listat tona pér ata që ne mendojmë se mund të pranojnë mesazhin e ungjillit!

Jezusi e dinte qëllimin e jetës së Tij: «Sepse

Biri i njeriut erdhi të kërkojë dhe të shpëtojë atë që kishte humbur» (Luka 19:10). Zot, na ndihmo që të jemi në misionin tonë po aq të qartë sa Jezusi ishte në misionin e Tij!

Autor: *David Roper*
Marrë nga seria: "*Tako Zotin*"
© 2001, 2003 E VERTETA PER SOT
Të gjitha të drejtat të rezervuara